

## Pasi e grabitën, 2 të rinjtë dhunojnë për vdekje të moshuarin në Mallakastër! Arrestohen autorët! Nipat: E kishin masakruar! Rast i përsëritur (VIDEO)

Është dhunuar për vdekje 89-vjeçari, Caush Shehaj i cili prej ditës së djeshme ndodhej në spitalin e Fierit ku po mjekohet pas goditjeve që kishte marrë nga dy grabitësit Ervis Halimi 22 vjeç dhe Musa Gudo 28 vjeç, të cilët nën kërcënimin e automatikut, i kanë marrë një shumë parash brenda banesës së tij.

- U dhunua për vdekje, nipi i viktimës: Tentuan ta grabisin dhe para një jave, të njëjtat persona
- I afërmi i viktimës: E kanë vrarë në 2 të natës, e kanë masakruar, e kanë shëmtuar nga fytyra



**LEXO EDHË:**  
**U dhunua fizikisht nga dy personat që i grabitën shtëpinë, vdes në spital i moshuari në Fier (EMRI)**

Të afërmit, zbuluan se i moshuari, Caush Shehaj ishte dhunuar në mënyrë barbare nga dy grabitësit, Ervis Halimi dhe Musa Gudo të cilët janë arrestuar nga policia.

Policia ka proceduar penalisht edhe 16 vjeçarin F.C nën akuzën e "moskallëzimit të krimi". Ndërsa është sekuestruar edhe arma e zjarrit tip automatik me të cilën është kryer grabitja.

Materialet do t'i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, për veprat penale "Vjedhja me dhunë", e kryer në bashkëpunim, "Plagosje e rëndë me dashje", "Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak" dhe "Moskallëzimi i krimi".

Lajm në përditësim

Rendit zhvillimet sipas orarit: 16 Fundit

Ora 10:53

'Pse vdiq Caushi? Joo', fqinjët për viktimën që u rrah barbarisht: Mbante një kasafortë të Enver Hoxhës, po ku kishte lekë brenda ajo

Report Tv ka shkuar në shtëpinë e 89-vjeçarit, Caush Shehaj, fqinjët e përshkruajnë viktimën si një njeri shumë të mirë, e ndërsa kanë treguar se mbante në shtëpi një kasafortë të para shumë vite, ndonëse aty nuk kishte lekë.

"Pse vdiq Caushi? Joo? Burri më i mirë në fshat, ka qenë tregtar. E kanë vjedhur më parë dhe më parë".

"Kam tentuar ta vjedhur, këta 2 djemët, kanë ardhur dhe dje dhe e kanë rrahur. Ata nga zona jonë janë, po kanë ikur në Fier me qira, e kishte kasafortën e Enverit dhe mendonin se kishte lekë, po ku kishte ajo", tregojnë fqinjët.

Ora 10:44

U rrah për vdekje pasi u grabit, Report Tv sjell pamje nga shtëpia 89-vjeçarit në Mallakastër

Report Tv sjell pamje nga banesa e 89-vjeçarit Caush Shehaj që u grabit nga 2 të rinjtë, Ervis Halimi 22 vjeç dhe Musa Gudo 28 vjeç. Siç shihet nga pamjet, gjendja ekonomike e çiftit nuk ka qenë shumë e mirë. I moshuari jetonte me bashkëshorten e tij, e cila vuan nga skleroza.

Ora 10:39

U dhunua për vdekje, nipi i viktimës: Tentuan ta grabisin dhe para një jave, të njëjtat persona

Nipi Asqeri Çela ka treguar se 89-vjeçari, Caush Shehaj ishte grabitur dhe njëherë më parë para 1 jave, por nuk ishte marrë asnjë masë.

"E kam dajë, është rasti i dytë dhe është i njëjti person që ka bërë të njëjtë, ka vajtur policia, mori shenjat e gishtave, dhe nuk u bë gjë radhën e parë, i morën çifte, dhe e vranë. Jetonte me të shoqen, është i sëmurë, femijet janë si gjithë detyrja të larguar. Duam drejtësi, shteti të vërë dorë", tha ai.

Ora 10:15

Grabitja me vdekje në Mallakastër/ I afërmi i viktimës: E kanë vrarë në 2 të natës, e kanë masakruar, e kanë shëmtuar nga fytyra

Një i afërmi i viktimës ka treguar detaje nga grabitja na Mallakastër. Ai tregon se 89-vjeçari ka rënë pre e grabitjes edhe një javë më parë, por autorët nuk morën asgjë. Ai thotë se 2 autorët e kanë masakruar.

"Jetonte me gruan, kishte probleme me gruan, sepse ishte me sklerozë dhe jetonin bashkë në kushte jo shumë të favorshme. Ata jetonin vetëm, i kishin vajtur një javë përpara për t'i vjedhur. Kjo ishte hera e dytë, policia nuk mori masa, punoi një jetën e tij dhe mbodhi 5 lekët dhe ato 5 lekë ia morën dhe dhunë. Ata mendonin për lekë të madh, po ai i kishte lekit në bankë, ka 4 femijë, 3 në Greqi dhe 1 në Francë. Jemi indigjuar por shteti nëse ka shtet e ligje, të të vrasin në shtëpinë tende. E kanë vranë në 2 të natës lakuria, e kanë shëmtuar masakruar nga fytyra, e brijja, nuk i duket mishi fare", tregon i afërmi.

Ora 10:01

U dhunua fizikisht nga dy personat që i grabitën shtëpinë, vdes në spital i moshuari në Fier (EMRI)

I moshuari, Caush Shehaj ka humbur jetën në sallën e reanimacionit në spitalin e Fierit, si pasojë e plagëve të marra nga dhuna që kanë ushtruar ndaj tij dy grabitësit, Ervis Halimi dhe Musa Gudo.

Lidhur me ngjarjen, policia procedoi penalisht edhe 16 vjeçarin F.C i cili akuzohet për 'moskallëzim krimi'. Është sekuestruar edhe arma e krimi tip 'automatik' me të cilën dy të rinjtë kanë kërcënuar të moshuarin 89-vjeçar.

B.V/LR/Shqiptaria.com

TAGS Musa Gudo Ervis Halimi Caush Shehaj Fier mallakastër grabitje

Komento

Komente

Xxxxxx 20/11/2022 12:04

Gjykatësit jan shtrresa me e ulet e shoqerise ...cudi sme beson njeri.ore jan plera fare ...

Përgjigju

Kushite extreme: 20/11/2022 11:48

Per ti varur ne mes te qytetit una lejon BE por une duhen lene ne burgim te perjetshem pa te drejte apeli

Përgjigju

Një: 20/11/2022 11:02

Ps pse policia duhet te merret me keto kriminelet! Policia duhet te merrt vetem me gjoha per te grabitur shoferet dhe jo per te kapur kriminelet!

Përgjigju

Alb: 20/11/2022 10:52

Kjo ashtie demokracia. Pa siguri pa punë droge vrasje. Lavdi PPSH

Përgjigju

Albana: 20/11/2022 11:25

Te lumte goja ishim te sigurt e dinte enveri cfar far e keqe do ishin njerzit.

Liluz: 20/11/2022 10:35

Kafshet masakrojne te moshuarin me vdekje duhet denim maksimal nga drejtesia.

Përgjigju

Keta vrases e kane ne gjak krimin.: 20/11/2022 10:16

Shteti duhet te shqije kapacitetet e burgjeve, ne menyre qe kriminelet vrases, te gendrojne mbyllur dhe mos dalin para kohen nga burgju, me arenen se duhen ndajere para kohe qe te lerojne vendet. Per keta vrases duhet denim maksimal. Shiko cfare ndodhi ne Anoli. Ne vrases i lena nga burgju dhe pas 9 ditesh grabiti, perdihuni dhe vrau nje vaze te re, e cila po kthehejne shtepi, pas nje nate jashte me shoqerine.

Përgjigju

Shejpaëria: 20/11/2022 10:26

Cili shtet?

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 60, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:

Berisha protestë ditën kur liderët e BE vijnë në Tiranë, si e vlerësoni?

Të dëgjo Të gabuar Nuk kam mendim

Lajme të tjera

3 vite nga rikonstruksioni degradon rruga e Semanit! Shinat mbli rrugë, s'ka tabelë sinjalizuese për rezikun

Protesta kundër traumat në Parkun e Divjakës, nën hetim kreu i PD Lushnjë, Eduart Sharka dhe 4 të tjerë, policia: Nuk ju binden efektiveve, bllokuan rrugën

Tra me pagesë në Parkun e Divjakës, banorët përplasen me policinë, kërkojnë të heqin kabinetin Korreshi për Report Tv: Është e vetmja rrugë që të çon në plazh (VIDEO)

VIDEO/ Tra me pagesë në Parkun e Divjakës, Rithemelimi' në protestë! Braçe për Report Tv: I paligjshëm! Ministria: Biletat do të jetë vetëm për turistët, jo banorët e zonës

Inceneratori i Fierit, SPAK 11 urdhër arreste të tjera, 5 në prangë, 6 në kërkim (EMRAT)! U paguan 4 milionë euro për punë të pakryera, 60 mln lekë dëm shtetit nga mashtrimi me TVSH

Sulmoi me thikë kryebashkiakun e Divjakës, lilet në burg Orges Xhelili! Avokati: Shkak hetimet e SPAK ndaj Kokoneshiti Babai: Se dinim se kishte probleme deri në këtë pikë

Tjetër avokate shpall kandidaturën në primaret e "Rithemelimi" për bashkinë e Fierit, Muça: Politika duhet të përfaqësohet nga figura të reja publike

'Jo çdo copë letër që u jepet është certifikatë pronësie', Artan Lame: Po tentohet falsifikimi i dokumenteve! Do demonshohen personat e përfshirë

Tre avokatë i bashkohen garës së Primareve të Rithemelimit për dy bashkitë Memaj nuk pranon të kandidojë për primaret e Kamzës

Grabitjet pika e këmbimit valutor në Divjakë! Autori i masakrës hyn me kallashnikov dhe merr paratë, bashkëpunëtorit me motocikletë e priti jashtë (VIDEO)

Kirurgu në Lushnjë flet për gjendjen e Kokoneshit dhe shoferit të tij: Kanë dëmtuar në mushkëri dhe stomak por janë jashtë rrezikut për jetën

Aksidenti i rëndë në Fier, 'Benz-i' përplas kalimtarin në mes të rrugës! Qytetarët përpiqen ta ngrenë

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju